



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË
ADMINISTRATORI

Njoftim

Njoftohen të gjithë studentët e Fakultetit të Mjekësisë që në zbatim të VKM - së nr. 40, datë 23.01.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 269, datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", të ndryshuar, VKM nr. 779, datë 26.12.2018, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 251, datë 27.03.2020. Janë hapur aplikimet për përjashtim/ ulje të tarifës së shkollimit për vitin akademik 2025-2026

Ftohen studentët që plotësojnë kushtet sipas VKM-ve të mësipërme të aplikojnë për këtë procedurë.

Kriteret dhe dokumentacioni që duhet të plotësojnë studentët është i publikuar në faqen e website www.fakultetmjekesise.edu.al

1. Fillimi i dorëzimit të dokumentacionit , sipas kriterëve për përfitim përjashtim/ ulje të tarifës së shkollimit. Faza e parë do të jetë nga datat 19.11-10.12.2025.
2. Dokumentacioni duhet të jetë i tre muajve të fundit (do të pranohen dokumenta me vull të njomë, të lëshuara nga institucionet përkatëse, (përveç dokumentave që do të shkarkohen nga e-albania).
3. Listat e studentëve me mesatare 9-10 që përfitojnë bursë do të përgatiten nga sekretaria mësimore. Këta studentë nuk duhet të dorëzojnë dokumentacion.
4. Dorëzimi i dokumentacionit për Fazën e parë, do të kryhet pranë ambjenteve të informacionit në Fakultetin e Mjekësisë

Në rast se do të ketë ndryshim të kriterëve studentët do të njoftohen përsëri në faqen e Fakultetit.

ADMINISTRATORI

ARLIND BROCI

Adresa: Rr.Dibrës, 371, Tirana, Albania; E-mail: infofm@fakultetmjekesise.edu.al; website:
www.fakultetmjekesise.edu.al
Tel. Fax: + 355 42362710



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË
ADMINISTRATORI

FORMULAR APLIKIMI PER PERFITIMIN TË ULJES SË TARIFËS SË SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026

Emër:	Programi Studimit
Atësi:	Cikli i Bachelor
Mbiemer:	Departamenti:
Vendlindja:	
Datëlindja:	Tel:
Nr. ID:	E-mail
Viti i Studimit:	Nr. matrikullimit:
Unë _____, student pranë Fakultetit të _____, paraqes kërkesën për të përfituar përjashtim/ulje të tarifës së SHKOLLIMIT, pasi plotësoj kushtet e përcaktuara në VKM nr. 40, datë 23.01.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 269, datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për përjashtim/ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë", Deklaroj se të dhënat e paraqitura nga ana ime si dhe dokumentacioni shoqërues që provon plotësimin e njërit prej kriterëve të renditura në vijim të kërkesës, të nënvizuara me shenjë X përbri kriterit, janë në dijeninë time të sakta dhe janë dokumenta zyrtare të marra nga institucione shtetërore dhe/ose të njohura me ligj. Jam në dijeni se deklarime të rreme nga ana ime në këtë kërkesë si dhe paraqitja e dokumentave të falsifikuar, përveç përgjegjësisë penale, sjellin automatikisht dhe heqjen e të drejtës për përfitim përjashtim/ulje të tarifës. Dokumentat shoqëruese janë origjinale ose kopje të noterizuara sipas kërkesës.	
Nënshkrimi	
Kriteret për përfitimin e përjashtimit / ulje nga tarifa për studentët e Fakultetit të Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2025-2026.	
Studentët në nevojë:	1. Studentë me aftësi të kufizuar, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë së Kufizuar për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar.
Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:	
1. Fotokopje të kartës së ID; ☐	
2. Certificate familjare e tre muajve të fundit ☐	

1 Adresa: Rr.Dibrës, 371, Tirana, Albania; E-mail: info@m-fakultetmjekesise.edu.al; website: www.fakultetmjekesise.edu.al

Tel. Fax: + 355 42362710

3.	Vërtetim lëshuar nga KMCAP (dokument fotokopje e noterizuar), ☐
4.	Vërtetim nga organet e qeverisjes vendore për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar. ☐
Studentët në nevojë:	2.Studentët, fëmijë të personave/familjes me aftësi të kufizuar, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë së Kufizuar për Pune, familjet e të cilëve trajtohen /përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë e vetqeverisjes vendorepërfitues, të pagesës së aftësisë së kufizuar. Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm: 1. Fotokopje të kartës së ID; ☐ 2. Vërtetim lëshuar nga KMCAP (për prindin)(dokument fotokopje e noterizuar); ☐ 3. Vërtetim nga organet e qeverisjes vendore për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar – dokument original lëshuar nga institucionet përkatëse. ☐ 4. Vërtetim nga organet e qeverisjes vendore që familja e studentit trajtohet me ndihmë ekonomike, ku të specifikohet numri i dosjes– dokument original lëshuar nga njësitë e qeverisjes vendore. ☐
Studentët në nevojë:	3.Studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm: 1. Fotokopje të kartës së ID; ☐ 2. Çertifikatë familjare e tre muajve të fundit; ☐ 3. Vërtetim nga organet e qeverisjes vendore që familja e studentit trajtohet me ndihmë ekonomike, ku të specifikohet numri i dosjes– dokument original lëshuar nga njësitë e qeverisjes vendore. ☐
Studentët në nevojë:	4. Studentët, deri në moshën 25 vjec që kanë vetëm njërin nga prindërit, pasi prindi tjetër është ndarë nga jeta, me të ardhura vjetore të familjes të pamjaftueshme për përballimin e kostos së studimeve. Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm: 1. Fotokopje të kartës së ID; ☐ 2. Çertifikatë familjare e tre muajve të fundit ☐ 3. Dokumenta që vërtetojnë të ardhurat familjare: vërtetim page, mase pensioni, ndihmë ekonomike, vërtetim për zotërim ose jo të aktivitetit tregëtar nga Drejtoritë Vendore të Tatimeve, vërtetim për zotërim pasurie të paluajtshme nga ZVRPP ose tokë bujqësore nga Zyrat e Administritimit dhe Mbrojtjes së Tokës dhe për personat e papunë vërtetim nga zyrat e punës për regjistrimin si punëkërkuar i papunë. 4.Certifikate vdekje e prindit. (në rast se njëri nga prindërit nuk jeton). ☐
Studentët në nevojë:	5.Studentë, të cilët kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç. Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm: 1. Fotokopje të kartës së ID. ☐ 2. Fotokopje e noterizuar e dokumentit për statusin e jetimit. ☐ 3. Çertifikatë familjare e tre muajve të fundit. ☐ 4. Çertifikatë e humbjes së dy prindërve. ☐
Studentët në nevojë:	6.Studentë të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë, deri 25 vjec.

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm: 1. Fotokopje të kartës së ID; ☐ 2. Çertifikatë familjare e tre muajve të fundit: ☐ 3. Fotokopje e noterizuar e vendimit të Gjykatës i formës së prerë. ☐		
Studentët në nevojë:		7.Studentët që janë identifikuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktime të trafikut të qenieve njerëzore, deri në moshën 25 vjeç.
Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm: 1. Fotokopje të kartës së ID; ☐ 2. Çertifikatë familjare e tre muajve të fundit: ☐ 3. Dokumentit vërtetues lëshuar nga organet përkatëse, për studentët që kanë përfituar statusin ligjor si viktime të trafikut. Dokument origjinal/fotokopje e noterizuar. ☐		
Studentët në nevojë:		8.Studentët të cilët janë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për ceshtjet e brendshme dhe ankesat, të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.
Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm: 1. Fotokopje të kartës së ID; ☐ 2. Çertifikatë familjare e tre muajve të fundit ☐ 3. Çertifikatë e humbjes së jetës së prindit (njërit); ☐ 4. Vërtetim të lëshuar nga institucioni përkatës i humbjes së jetës së prindit në krye të detyrës – dokument origjinal. ☐		
Studentët në nevojë:		9.Studentët romë dhe egjiptianë, të cilët do të identifikohen nëpërmjet vetëdeklarimit.
Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm: 1. Fotokopje të kartës së ID; ☐ 2. Vetëdeklarim noterial. ☐		
Studentët në nevojë:		10.Studentë, fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politik me heqje lirie.
Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm: 1. Fotokopje të kartës së ID. ☐ 2. Çertifikatë Familjare që vërteton lidhjen e studentit me prindin të ish- të dënuarve dhe të përndjekurve politike nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie; ☐ 3. Vërtetim i statusit të prindit ish të përndjekur/ dënuar politik- dokument origjinal; ☐ 4. Dëshmi penaliteti për prindin ish të përndjekur politik ose vërtetim për kohën e dënimit të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme – dokument origjinal. ☐		

Emër Mbiemër

Firmë

nr.celularit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË
ADMINISTRATORI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2025

FLETË INVENTARI PËR DOMENTACIONIN E DORËZUAR PËR PËRJASHTIM/ULJE TARIFE

Dokumentacioni i cili dorëzohet është si më poshtë vijon:

- | | |
|---|-----------|
| 1. Fotokopje e Kartës së Identitetit të personit që dorëzon dokumentacionin | -----faqe |
| 2. Nr. i llogarisë bankare | -----faqe |
| 3. Formulari i aplikimit | -----faqe |
| 4. _____ | -----faqe |
| 5. _____ | -----faqe |
| 6. _____ | -----faqe |
| 7. _____ | -----faqe |
| 8. _____ | -----faqe |
| 9. _____ | -----faqe |
| 10. _____ | -----faqe |

Total nr.----- faqe

Studenti

Emër Mbiemër _____

Firma _____

Shënime _____